



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:028409
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05844921

C.nr.139/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësve V.G, nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, A.B, nga Rahoveci, A.K-H, nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, E.D, nga Rahoveci, dhe I.G, nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson av. S.B, nga Prishtina, sipas autorizimeve në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 8,258.64 euro, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve V.G, nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, A.B, nga Rahoveci, A.K-H, nga fshati Retijë, Komuna e Rahovecit, E.D, nga Rahoveci, dhe I.G, nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit V.G, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.12.2022, për 35% të pagës bazë (421.00 euro) x 35% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 147.35 euro) = 89.03 euro x 24 muaj, t'ia paguaj shumën prej 2,136.72 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 23.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm”.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.B, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.12.2022, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 24 muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,328.40 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 23.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm”.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.K-H, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.12.2022, për 35% të pagës bazë (393.00 euro) x 35% (minusuar 54.45 euro në listën e pagave nga shuma 137.55 euro) = 83.10 euro x 24 muaj, t'ia

paguaj shumën prej 1,994.40 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 23.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit E.D, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.12.2022, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 24 muaj, t’ia paguaj shumën prej 1,328.40 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 23.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit I.G, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.12.2022, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 24 muaj, t’ia paguaj shumën prej 1,328.40 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 23.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

VII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses së tretë A.K-H për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 1,994.40 euro e deri në shumën prej 2,136.72 euro dhe atë për shumën prej 142.32 euro.

VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve V.G, A.B, A.K-H, E.D, dhe I.G, t’ia paguajë shumën prej 373.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

IX. Refuzohet kërkesa për kompensimin e shpenzimeve procedurale mbi shumën e aprovuar si në pikën VIII të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit V.G, A.B, A.K-H, E.D, dhe I.G, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 23.01.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 8,258.64 euro.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se janë në marrëdhënie të punës pranë të paditurës me kontratë valide të punës si mësimdhënës, paditësit V.G, A.B, A.K-H, E.D, dhe I.G e cila punon si mësimdhënëse në institucionin arsimor SHFMU "Ardhmëria" në Rahovec. Paditësve në bazë

të nenit 7 pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të vitit 2021, ju takon e drejta e realizimit të kompenzimit nga licencimi, për 10% të pagës mujore, e cila e drejtë për kompenzim llogaritet nga koha e licencimit të mësimdhënësve. Padiësit kanë kualifikim-gradë të shkollimit të përcaktuar sipas sistemit Diplomë Fakulteti-Bachelor dhe Master, të lëshuar nga universiteti përkatës, për secilin padiës.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 24.04.2024, ku ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që Ministria e Arsimit si palë nënshkruese e kësaj kontrate, nuk ka ndarë mjetet financiare të nevojshme për Komunën e Rahovecit. Padiësja A.B, ka parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të kualifikimit, e evidentuar pranë kësaj gjykate me numër të lëndës 2022:208643, C.nr.622/2022.

Padiësja A.K-H, ka parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të kualifikimit, e evidentuar pranë kësaj gjykate me numër të lëndës 2022:208709, C.nr.627/2022.

Padiësi E.D, ka parashtruar padi tjetër për kompensim në emër të kualifikimit, e evidentuar pranë kësaj gjykate me numër të lëndës C.nr.565/2021. Padiësit nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse padiësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e padiësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 271/2 e datës 01.09.2016, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe padiësit V.G; diplomën Nr. 98 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prishtinë, e padiësit V.G; licenca e mësimdhënësit nr.100009869; lista e pagës e datës 31.08.2022; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 200/01 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe padiësës A.B; licenca e mësimdhënësit nr.100022463; lista e pagës e datës 28.02.2021; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 186/01 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe padiësës A.K-H; diplomën nr.661, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik në Prishtinë, e padiësës A.K-H; licenca e mësimdhënësit nr.1027696; lista e pagës e datës 28.02.2021; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 190/01 e datës 01.09.2016, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe padiësit E.D; diplomën Nr. 1086 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, e padiësit E.D; licenca e mësimdhënësit nr.100009739; lista e pagës e datës 31.03.2021; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 189/01 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe padiësit Ismajl Gashi; diplomën Nr. 785 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë e padiësit I.G; licenca e mësimdhënësit nr.100009709; lista e pagës e datës 28.02.2021.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kishin të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit posedojnë licenca. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe licencimit, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 271/2 e datës 01.09.2016, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit V.G, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “7 Shtatori” në Rahovec.

Me administrimin e diplomës Nr. 98 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prishtinë, e paditësit V.G, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.G ka përfunduar studimet më 13.10.2015 dhe mori titullin Master i Edukimit – Udhëheqja në Arsim.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit nr. 100009869, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.G është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e listës së pagave e datës 31.08.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësi V.G, ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 200/01 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses A.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Ardhmëria” në Rahovec.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit nr. 10022463, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.B është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e listës së pagave e datës 28.02.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.B, ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 186/01 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses A.K-H, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Ardhmëria” në Rahovec.

Me administrimin e diplomës nr.661, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik në Prishtinë, e paditëses A.K-H, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.K-H ka përfunduar studimet dhe mori titullin Master i Pedagogjisë.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit nr. 1027696, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.K-H është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e listës së pagave e datës 28.02.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.K-H, ka pasur pagën bazë 393,00 €.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 190/01 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit E.D, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Ardhmëria” në Rahovec.

Me administrimin e diplomës Nr. 1086 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, e paditësit E.D, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.D ka përfunduar studimet më 06.07.2010 dhe mori titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit nr. 100009739, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.D është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e listës së pagave e datës 31.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi E.D, ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 189/01 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit I.G, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Ardhmëria” në Rahovec.

Me administrimin e diplomës Nr. 785 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë e paditësit I.G, gjykata vërtetoi faktin se paditësi I.G ka përfunduar studimet më 26.04.2014 dhe mori titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit nr. 100009709, gjykata vërtetoi faktin se paditësi I.G është i licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e listës së pagave e datës 28.02.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi I.G, ka pasur pagën bazë 421,00 €.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve për shkak se në bazë të nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës e datës 18.04.2017, përcaktohet se *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.1 . Mësimdhënës me Shkollë Normale 10% e pagës bazë; 1.2. Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë; 1.3 . Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27 % e pagës bazë; 1.4 Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë; 1.5 Përparimet në karrierë, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10 %”, si dhe në bazë të nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit e*

Kosovës e datës 21.01.2021, “Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA Nr. 5/2017 Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale, si vijon: 1.1 Mësimdhënës me Licencë të karrierës 10 % e pagës bazë. 1.2 Mësimdhënës me Licencë të avancuar 10% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me Licencë mentor 15% e pagës bazë. 7 1.4 Mësimdhënës me Licencë meritore 15% e pagës bazë”. Gjykata vlerëson se në bazë të këtyre dispozitave ekziston detyrimi i të paditurës që t’i kompensojë paditësit në emër të kompensimit nga marrëdhënia e punës dhe atë në bazë të kualifikimit. Pra, nga neni 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës e datës 21.01.2021 shihet qartë se paragrafi 1 i këtij neni u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhura personale të pagës bazë.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjejmësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parashihet “Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune” dhe paragrafi 4 “Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Po ashtu, gjykata ka analizuar edhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4 të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës. Në këtë rast paditësve A.B, E.D, dhe I.G në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedojnë diplomë të nivelit Bachelor i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 27%. Ndërsa paditësve V.G dhe A.K-H, në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedon diplomë të nivelit Master i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 35%.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë paditëses së tretë A.K-H, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 1,994.40 euro e deri në shumën prej 2,136.72 euro dhe atë për

shumën prej 142.32 euro, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008 në pikën 4 nën-pikën 4 të vendimit përcaktohet se *“Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”.*, në këtë drejtim paditësja në kërkesëpadi ka kërkuar që të kompensohen për 35% të pagës mujore (393.00 euro) për paditëses A.K-H, ndërsa bazuar në pikën 4 të Vendimit të Qeverisë, paditësit përfitojnë ngritje në bazë të pagës bazë dhe jo në bazë të pagës mujore siç pretendojnë paditësit.

Sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 09.10.2023, realizimi i të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22.01.2021, duhet të trajtohen deri më datën 21.11.2022, kur edhe është shkëputur kjo kontratë nga njëra kontaktuese. Andaj, kërkesës që përfshin periudhën kohore prej datës 22.11.2022 deri më datë 21.09.2023, janë refuzuar për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.* Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e tyre e aprovoi pjesërisht pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtuftjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2, nenit 7 dhe nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, Udhëzimit Administrativ

Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”,* në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën VIII të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 373.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 312.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 61.00 euro.

Gjykata ka vendosur si në pikën IX të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se shpenzimet tjera për përpilimin e parashtresave të kërkuara nuk hyjnë në shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës gjyqësore konform nenit 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.139/2024, më datë 21.06.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.